



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Sigurinë Kombëtare

Tiranë më 15.07.2014
Dokument parlamentar

R A P O R T

“Për Dekretin e Presidentit të Republikës, nr. 8620, datë 04.07.2014 “Për kthimin për rishqyrtim të ligjit nr. 59/2014 “Për Karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, në cilësinë e komisionit përcaktues në mbledhjen e datës 15 korrik 2014, mori në shqyrtim dekretin e Presidentit të Republikës nr. 8620, datë 04.07.2014 “Për kthimin për rishqyrtim të ligjit nr. 59/2014 “Për Karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

Për zhvillimin e procedurës së shqyrtimit të dekretit, komisioni fitoi përfaqësues të Ministrisë së Mbrojtjes.

Presidenti i Republikës, bazuar në nenin 85, pika 1 dhe 93 të Kushtetutës, ka vendosur kthimin e ligjit nr. 59/2014 “Për Karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, për këto arsye:

Arsyet e kthimit të ligjit nr. 59/2014:

- **Tejkalim dhe uzurpim i funksionit kushtetues të Presidentit të Republikës, në cilësinë e Komandantit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.**
Sipas arsyetimit bashklidhur dekretit për kthim për rishqyrtim të ligjit, Presidenti i Republikës mendon se i janë cënuar kompetencat kushtetuese pasi ligji i miratuar nr. 59/2014, në nenet 25 dhe 26 përcakton se dalja në rezervë dhe lirim i kategorisë së oficerëve me gradë më të lartë, është një kompetencë ekskluzive e Presidentit të Republikës;
ky ligj, nuk është konsultuar paraprakisht me Komandantin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe ka rrezikuar zinxhirin e komandimit/kontrollit të Forcave të Armatosura;

- **Ky ligj bie ndesh me ligjin nr.8671, datë 26.16.2000 “Për Pushtetet dhe Autoritetet e Komandimit dhe Drejtimit Strategjik të Forcave të Armatosura¹”, (pikat 7 dhe 8 i nenit 7) i cili shprehet qartë për rolin e Komandantit të Përgjithshëm në hierarkinë e pushteteve dhe autoriteteve si dhe përcaktimin e kompetencës së Komandantit të Përgjithshëm në lidhje me karrierën e oficerëve me gradë madhore.**
- **Si konkluzion, Presidenti i Republikës, me anë të dekretit ka risjellë për rishqyrtim ligjin nr. 59/2014 në Kuvend me arsyetimin se bie ndesh me nenet 168 pika 2, 169 pika 1 dhe 4 e Kushtetutës.**

➤ Baza Ligjore

A. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Neni 85

1. Presidenti i Republikës ka të drejtë ta kthejë ligjin për rishqyrtim vetëm një herë.
2. Dekreti i Presidentit për rishqyrtimin e një ligji e humbet fuqinë, kur kundër tij votojnë shumica e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

B. Rregullorja e Kuvendit

Neni 86

Dekreti i Presidentit të Republikës për rishqyrtim ligji

1. Kur Presidenti i Republikës, në përputhje me nenin 85 të Kushtetutës, rikthen ligjin për rishqyrtim në Kuvend, Kryetari i Kuvendit e kalon menjëherë atë për shqyrtim në komisionin përgjegjës që e ka shqyrtuar fillimisht.
 2. Komisioni përgjegjës e shqyrton dekretin vetëm për çështjet e paraqitura nga Presidenti i Republikës dhe brenda 8 javëve nga data e fillimit të shqyrtimit paraqet raportin e tij. Ky raport përmban mendimin e komisionit dhe, sipas rastit, edhe propozime për nene të veçanta të ligjit.
1. Lidhur me arsyen e parë, për **tejkalim dhe uzurpim i funksionit kushtetues të Presidentit të Republikës**, në cilësinë e Komandantit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.
 - **Ligji nr. 59/2014, nuk uzurpon dhe nuk tejkalon asnjë funksion apo kompetencë kushtetuese të Presidentit të Republikës**, në cilësinë e tij si Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, për këto arsye:
 - **Neni 169 i Kushtetutës**, parashikon qartë se **1. ‘Presidenti i Republikës, në kohë paqeje**, ushtron drejtimin e Forcave të Armatosura **nëpërmjet Kryeministrit dhe ministrit të Mbrojtjes**. **2.** Presidenti i Republikës, në kohë lufte, emëron dhe shkarkon Komandantin e Forcave të Armatosura me propozim të Kryeministrit. **3.** Me propozim të Kryeministrit, emëron dhe shkarkon Shefin e Shtabit të

¹ Ligji shfuqizuar nga Ligji nr. 64, datë 20.06.2014, i cili përcaktoi funksionet e Komandantit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës

Përgjithshëm, si dhe me propozim të ministrit të Mbrojtjes, emëron dhe shkarkon komandantët e forcave tokësore, detare dhe ajrore. **4. Kompetencat e Presidentit** të Republikës si Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura dhe ato të Komandantit të Forcave të Armatosura dhe varësia e tyre nga organet kushtetuese, **caktohen me ligj.**

Duke bërë një interpretim tekstual, *ad literam (literal)* e logjik të nenit 169 të Kushtetutës, kjo në lidhje me nenin 1 pika 1, nenit 2 pika 3 dhe nenit 12 të Kushtetutës, kuptojmë se autoritetet drejtuese dhe komanduese kryesore të Forcave të Armatosura janë: Kuvendi i Shqipërisë, Presidenti i Republikës, Kryeministri dhe Ministri i Mbrojtjes. **Në respektim të pikës 4 të nenit 169, nenit 81 dhe 83 të Kushtetutës, kompetencat e Presidentit të Republikës si komandant i Forcave të Armatosura, caktohen me ligj.** Caktimi i kompetencave të Presidentit të Republikës si Komandant i Forcave të Armatosura në ligjin nr. 59/2014 "Për Karrierën Ushtarake në Forcat e Armatosura", nuk ka cënuar apo uzurpuar asnjë kompetencë kushtetuese të Presidentit të Republikës, sidomos ato të përmendura në arsyetimin e dekretit, nenet 168 pika 2, 169 pika 1 dhe pika 4 të Kushtetutës. Në ligjin nr.59/2014 janë mbajtur parasysh dhe janë respektuar detyrimet kushtetuese të sanksionuara në nenin 92/d, 168 dhe nenin 169 pika 1 dhe 4 të kushtetutës. Kompetencat e njohura Presidentit me ligj, duhet që ato jo vetëm të burojnë dhe të kenë lidhje të drejtpërdrejtë me një normë dhe kompetencë kushtetuese, por edhe ta pajisin Presidentin e Republikës me një pushtet të njohur për ushtrimin e funksionit, për të cilin i janë njohur, si në rastin konkret në ligjin nr. 59/2014. Këshilli i Ministrave në cilësinë e organit kushtetues kryesor me nismë ligj-propozuese ka të drejtë të propozojë nisma apo ndryshime ligjore, për miratim në Kuvend, në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Në këtë kuptim, në përputhje me nenin 196/4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i cili ndër të tjera përcakton se kompetencat e Presidentit të Republikës si Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura rregullohen me ligj.


2. **Lidhur me arsyen e dytë** se ky ligj, nuk është konsultuar paraprakisht me Komandantin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe ka rrezikuar zinxhirin e komandimit/kontrollit të Forcave të Armatosura:
 - Mendojmë se kjo arsye nuk përbën qëllim dhe arsye kushtetuese dhe ligjore për ta kthyer për rishqyrtim ligjin pasi edhe komisioni për sigurinë kombëtare me iniciativën e tij, gjatë shqyrtimit të këtij ligji herën e parë, me anë të ftesës zyrtare ftoi Institucionin e Presidentit të Republikës me qëllim të njoheshim me mendimet dhe sugjerimet e Presidentit të Republikës në cilësinë e tij si Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura në raport me ligjin nr. 59/2014. Siç mund të jeni në dijeni edhe ju të nderuar anëtarë të komisionit, Presidenti i Republikës nuk ju përgjigj kësaj ftese.
3. **Lidhur me arsyen e tretë** se ky ligj bie ndesh me ligjin nr.8671, datë 26.16.2000 "Për Pushtetet dhe Autoritetet e Komandimit dhe Drejtimit Strategjik të Forcave të Armatosura (pikat 7 dhe 8 i nenit 7) i cili shprehet qartë për rolin e Komandantit të


Përgjithshëm në hierarkinë e pushteteve dhe autoriteteve si dhe përcaktimin e kompetencës së Komandantit të Përgjithshëm në lidhje me karrierën e oficerëve me gradë madhore.

Theksoj se ligji nr. 59/2014, nuk bie ndesh me kompetencat e njohura Presidentit në ligjin nr. 8671, datë 26.16.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit dhe drejtimit strategjik të FA”, pasi ligji 59/2014 “Për gradat dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, është paraqitur në formën e një pakete ligjore së bashku me ligjin nr. 64, datë 26.06.2014 “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit dhe të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”. Ligji nr. 64/2014 është miratuar në Kuvend në datë 26.06.2014, pasi kaloi fazat e shqyrtimit dhe miratimit në komisionet përgjegjëse parlamentare. Ligji 59/2014 “Për gradat dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë” dhe ligji 64/2014 “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit dhe të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, janë hartuar në harmoni të plotë lidhur me parashikimet përkatëse mbi rolin e Komandantit të Përgjithshëm në hierarkinë e pushteteve dhe autoriteteve të Forcave të Armatosura, si dhe mbi kompetencat e tij në lidhje me karrierën e oficerëve me gradë madhore.

Përfundim: Ligji nr. 59/2014, nuk ka cënuar asnjë dispozitë apo kompetencë kushtetuese të Presidentit të Republikës pasi edhe raporti kushtetues i Presidenti në një republikë parlamentare, në rastin e Kushtetutës së RSH-së, ka parashikuar një kryetar shteti joqeverisës, tipike kjo për një republikë parlamentare. *Presidenti nuk qeveris dhe nuk administron, ai qëndron mbi të gjitha pushtetet, por nuk bën pjesë në to.* Ai konsiderohet si një organ *sui generis*. Ky raport kushtetues i Presidentit të Republikës me Këshillin e Ministrave dhe Kuvendin e Shqipërisë manifestohet mjaft mirë edhe në kuptimin logjik të nenit 168 dhe 169 të Kushtetutës, ku kompetenca e drejtimit *civil* të forcave të armatosura është një kompetencë ekzekutive dhe ushtrohet në kohë paqeje nëpërmjet Kryeministrit dhe ministrit të Mbrojtjes por pa e zhveshur Presidentin nga mundësia e kontrollit dhe pushtetit, të shprehur në Kushtetutë si në rastin konkret për këtë projektligj.

Për këto arsye, bazuar në nenin 85 pika 2 e Kushtetutës, komisioni për sigurinë kombëtare me shumicën e anëtarëve të tij votoi kundër dekretit të Presidentit të Republikës.

Relator


Kryetar
Spartak BRAJTO

4



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Sigurisë Kombëtare

Tiranë.27/05/2014
Dokument Komisioni

Relator
Arben Çirko

Relatim

Lidhur me projektligjin “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”

Të nderuar kolegë/e të komisionit!

Përgatitja dhe sjellja e projektligjit të ri për ‘*Karrierën ushtarake në F.A*’ për miratim në Komisionin e Sigurisë Kombëtare; përbën për mendimin tim një iniciativë në kohën e duhur dhe një hapë të rëndësishëm në plotësimin e paketës ligjore nga ekipi i ri i ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura.

Ligji nr. 9171, datë 22/01/2004 “*Për gradat dhe karrierën ushtarake në Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë*” deri tani, ka luajtur një rol të rëndësishëm për vendosjen e një sistemi modern të gradave dhe të karrierës ushtarake në F.A.

Gjatë zbatimit të këtij ligji në praktikë, për një kohë relativisht të gjatë prej 10 vjetësh, janë konstatuar disa probleme, të cilat me këtë projektligj të ri, synohet të korrigojnë.

Së pari: sipas **ligjit aktual**, ushtarakët i nënshtrohen një rregulli të vetëm; **përparim në gradë**, në të kundërt dalje nga shërbimi aktiv në Forcat e Armatosura. Kjo ka bërë që të shtohen ushtarakët e dalë në rezervë/lirim dhe që paguhen me pension të parakohshëm për vitet e shërbimit dhe me pagesë kalimtare.

Mesatarisht ushtarakët me gradë kapiten kanë dalë në rezervë në moshën 40 vjeç, majorët në moshën 45 vjeç, nënkolonelët në moshën 50 vjeç dhe kolonelët në moshën 53 vjeç. Periudhën e zbatimit të ligjit aktual, janë nxjerrë në rezervë, mesatarisht 150-195 oficerë në vit.

Ndërsa **projektligji i ri parashikon rritjen e moshës** për daljen në rezervë/lirim të ushtarakëve të karrierës për gradat e oficerëve nga major e lart dhe gradat e nënoficerëve nga rreshter e lart.

- Si rezultat i **rritjes së moshës** për ushtarakët e karrierës, kemi ulje të numrit të ushtarakëve që dalin në rezervë/lirim para kohe nga F.A, për rrjedhojë **kemi edhe pakësim të numrit të rekrutimeve të reja** në Forcat e Armatosura, e cila ndikon dhe në uljen e kostove financiare për buxhetin e shtetit për F.A.

- Sipas ligjit në fuqi, ish ushtarakët që dalin në rezervë/lirim, janë subjekt i trajtimit financiar nga shteti. Aktualisht numri i ushtarakëve në rezervë/lirim është rreth 17.500 persona, që përbën një barrë e rëndë për buxhetin por është një tendencë në rritje. Vetëm gjatë vitit 2013 janë trajtuar me pagesë kalimtare rreth 1150 ish ushtarak, që nënkupton që çdo vit dalin në rezervë/lirim dhe përfitojnë trajtim financiar rreth 500-600 ish ushtarak.

- Futja e koncepti të **shërbimit të përkohshëm me kontratë** dhe atij të **karrierës** në F.A është **një tjetër risi** e këtij projektligji. Synimi i kësaj ndërhyrje është vendosja e një standardi që zbatohet gjerësisht në NATO, i cili do të sjellë një tjetër impuls pozitiv në drejtim të konkurrimit mes ushtarakëve për t'u përfshirë në shërbimin e karrierës.

Sipas këtij koncepti, oficerët që arrijnë të marrin **gradën major** dhe nënoficerët që arrijnë të marrin **gradën rreshter** përfshihen në shërbimin e karrierës, duke siguruar një kohë qëndrimi më të gjatë në F.A

Së dyti : Krijimi i **kategorisë së re të gradave** për specialitetet shënon një tjetër arritje. Ky projektligj **parashikon gradat për specialitetet** si : mjek dhe personelin e orkestrës frymore të F.A, që u jepen për shkak të eksperiencës profesionale si dhe kualifikimit në fushën përkatëse, pa kërkuar domosdoshmërisht kualifikime të përgjithshme ushtarake.

Në projektligj parashikohet **shtimi edhe të dy niveleve të gradave** për ushtarët profesionist, si dhe përfshirjen e nënoficerëve në sistemin e vlerësimit të komisioneve të karrierës, kur trajtohen nënoficerët. Kategoritë e

ushtarakëve, të cilat janë ushtarakë të shërbimit aktiv dhe në rezervë. Ushtarakët e shërbimit aktiv në F.A, janë oficerët, nënoficerët dhe ushtarët/detarët.

Qëllimi i projektligjit është: përcaktimi i kriterëve për pranimin në F.A, rendin e gradave, përparimin në gradë dhe karrierë, ndërprerjen e karrierës ushtarake, si dhe autoritetet përgjegjëse për zhvillimin e karrierës në F.A.

Projektligji, **në nenin 13**, parashikon kohën e qëndrimit në një gradë për marrjen e asaj të radhës. Pa u plotësua ky kusht ushtarakët nuk mund të konkurrojnë për gradën e radhës. **Në rast mos përparimi në gradë**, ushtarët me gradën ushtar IV, nënoficerët me gradat nëndetar, tetar dhe oficerët me gradat nëntoger, toger, kapiten, që plotësojnë 14 vite shërbimi aktiv në F.A, pavarësisht parashikimeve të pikës 1, të nenit 14, të projektligjit, **do të dalin në rezervë**.

Së treti : Në projektligj përjashtim është bërë vetëm për oficerët me grada madhore (gjeneral brigade /kundëradmiral e lartë). **Oficeri me gradë madhore, pavarësisht mosplotësimit të moshës** së përcaktuar në pikën 1, të nenit 14 të projektligjit dhe pavarësisht mosplotësimit kriterëve të përcaktuara në nenet 26 dhe 27 të tij, **do të nxirret në rezervë apo lirim kur plotëson njërin nga këto kriterë**.

- 1- Kur pas kalimit të kohës së qëndrimit në një gradë sipas pikës 1, të nenit 13, të këtij ligji, nuk ka marrë gradën e radhës;
- 2- Kur nuk ka kuota të lira për konkurrim për gradën e radhës, sipas tabelës së organizimit dhe pajisjeve.

Oficer aktiv i F.A, do të titullohen shtetasi shqiptar që plotëson një nga kriteret dhe bënë betimin ushtarak.

-Të ketë kryer arsimin e lartë ushtarak brenda vendit;- Të ketë kryer arsimin e lartë ushtarak dhe ciklin e parë të studimeve të larta pas arsimimit ushtarak jashtë vendit;- Të ketë kryer ciklin e parë të studimeve të larta, brenda ose jashtë vendi dhe kursin përkatës ushtarak jo më pak se një vit në institucionet arsimore ushtarake. **Titulli ‘oficer aktiv’** dhe dhënia e gradës së parë ‘nëntoger’ të oficerit do të bëhet **me urdhër të ministrit të Mbrotjtjes** me propozim të titullarit të institucionit arsimor.

Së katërti : Vlerësimet e ushtarakëve për marrjen e gradës së radhës do të bëhet nga **komisionet e karrierës**, të cilat janë autoritetet përgjegjëse për vlerësimin e përparimin e ushtarakëve në gradë. Do të **ketë katër komisione** karriere:

1- Komisioni i veçantë për marrjen e gradave madhore; 2- Komisioni i lartë për vlerësimin e dhënien e gradave major/kapiten i rangut III deri kolonel/kapiten i rangut I, si dhe nënoficerët për marrjen e gradës krye kapter; 3- Komisioni i zakonshëm për oficerët me grada të ultë; 4- Komisioni i zakonshëm për nënoficerët.

Komisionet e karrierës do të ngrihen me urdhër të ministrit të Mbrojtjes me propozim të Shefit Shtabit Përgjithshëm, në të nuk bëjnë pjesë anëtarët e kabinetit ministrit Mbrojtje dhe ushtarakët e shërbimeve inteligjente me përjashtim të rasteve të parashikuar në shkronjën 'b', 'c' dhe 'ç' të pikës 3 të nenit 23 të projektligjit.

Në projektligj është parashikuar edhe **rastet e pezullimit të ushtarakëve** nga detyra, si ndërprerja e përkohshme e marrëdhënieve me punën. Gjatë periudhës së pezullimit ushtaraku nuk paguhet, pezullimi i oficerit detyra do të bëhet me urdhër nga ministri i Mbrojtjes.

Së pesti : Dalja në **rezervë e ushtarakut** nga shërbimi ushtarak kur plotëson njërin nga kushtet që parashikohet në projektligj. **Shefi i Shtabit** të Përgjithshëm del në lirim **me dekret** të Presidentit të Republikës me propozim të Kryeministrit, oficerët me **gradë madhore, dalin në lirim me urdhër të Kryeministrit, me propozim të ministrit të Mbrojtjes**, ndërsa të gjithë oficerët e tjerë dalin në lirim me urdhër të ministrit të Mbrojtjes me propozim të Shefit të Shtabit Përgjithshëm. Në rastet e rikthimit në Forcat e Armatosura, ushtarakët mbajnë gradën që kishin në çastin e daljes në rezervë/lirim.

Në proceset e **riorganizimit** strukturor të F.A, për mungesë funksioni organik, ushtaraku me pëlqimin e tij, mund të emërohet në një funksion më të ulët duke mbajtur gradën që ka, por jo **më shumë se tre vjet**.

Mospërputhja gradave me funksionet organike në F.A nuk duhet të kalojë masën 10% të numrit të përgjithshëm të personelit ushtarak. Dalja në rezervë e lirim, do të bëhet duke mos cenuar operacionalitetin dhe gatishmërinë e strukturave të F.A

Me parashikimet e projektligjit të ri, shkurtohen nga periudha e pagesës kalimtare dhe atë të pensionit të parakohshëm, për çdo vit rreth **920 oficerë** dhe **1950 nënoficerë**. Shprehur në vlerë leku, buxheti i shtetit i **kursehen rreth 617,2 milion lekë për çdo vit**.

Një shpjegim!

Mosha e marrjes së titullit ‘oficer aktiv’ dhe gradës së parë.

Sipas nenit 14 pika 4; Mosha minimale e pranimit në Forcat e Armatosura është 18 vjeç.

Shtetasi, në momentin e titullimit oficer aktiv mund të ketë mbushur **moshën 21 vjeç ose më shumë deri 27 vjeç** (duhet marrë e përgjithshmja mosha 21 vjeçare).

Ndërsa në nenin 17 pika 3. Grada ‘Nëntoger’ u jepet shtetasve që janë titulluar ‘oficer aktiv’. At’here nëse ushtaraku titullohet oficer aktiv në moshën 21 vjeç dhe merr gradën e parë të ‘Nën/togerit’.

N/togeri sipas projektligjit në nenin 13 pika ‘1’ germa ‘f’ do të qëndrojë tre vjet në këtë grade. Ndërsa grada e **‘togeri’** merret në **moshën 24 vjeç**, grada e **kapitenit** merret në **moshën 29 vjeç**, grada e majorit merret në **moshën 35 vjeç**, grada e n/kolonelit merret në moshën **40 vjeç**, grada e kolonelit merret në **moshën 45 vjeç**.

Sipas kësaj renditje, bazuar tek projektligji, konstatohet se: kohë qëndrimi në gradat e larta është i gjatë, konkretisht :

së pari :Kapiteni bëhet ‘Major’ kur ka mbushur **moshën 35 vjeç**, sipas nenit 14 pika 1, germa ‘i’ në se **‘Majori’** nuk merr gradën e n/kolonelit, qëndron në këtë gradë deri **moshën 55 vjeç (rreth 20 vjet)**.

Së dyti: Kurse grada e n/kolonelit merret në moshën **40 vjeç**, sipas nenit 14 pika 1 germa ‘j’, në se nuk merr gradën e kolonelit, qëndron në gradë deri në moshën **57 vjeç (rreth 17 vjet)**.

Së treti : Ndërsa grada e 'kolonelit' merret në moshën **45 vjeç**, në se nuk përparon në gradë, sipas nenit 14 pika 1 germa 'k' qëndron në gradë deri në moshën **59 vjeç (rreth 14 vjet)**.

Shënim!

Edhe në se rrisim nga një vit të kohë qëndrimit në gradë të rangjeve të ulta nuk luan ndonjë rol të madh tek kohë-qëndrimi në detyrë të gradave të larta. Megjithatë ndikimi qëndron sepse ulet rreth 2-3 vjet koha e qëndrimit në gradat e larta, por varet se në çfarë moshe bëhet jepet grada e 'nëntogerit'.

Në se nuk përparojnë në gradë kapitenët në moshën **41 vjeç** dalin në rezervë pa përfituar të drejtën e statusit. Sipas diskutimit që bëme bashkë për nenin 13 pika 1 germa 'f', 'g', 'gj', mundet të propozohet të rritet koha e qëndrimit në detyrë të gradave të ulta deri një vit (nga 3 në 4 vjet, nga 4 në 5 vjet, nga 5 në 6 vjet). Me këtë lëvizje, kapitenët edhe nëse nuk përparojnë në gradën e radhës fitojnë statusin.

Ndërsa për moshën e qëndrimit në shërbim aktiv të kolonelëve, sipas diskutimit që bëme, na rezulton se : **Koloneli qëndron 14 vjet në një gradë.**

Në rastë se do propozonit që të viheshin fikse qëndrimi jo më shumë se **11 vjetë** në gradat e larta, at'here na del një **kohë tre vjeçare** nga kolonelët që **duhet mbuluar**. U takon që grada e kolonelit të ketë moshën maksimale të qëndrimit në **detyrë 56 vjeç, e nën/kolonelit 54 vjeç, e majorit 52 vjeç.**

Hyrja në fuqi e ligjit të ri me propozimin që dhatë për në janar 2015 qëndron, por duhet argumentuar kur të kalojë diskutimi nënë për nen.